

MACROSAN FINITURA

FINITURA ZBUKURUESE

Karakteristikat

MACROSAN FINITURA është një linjë sheshuesish mineralë gati për përdorim me bazë gëlqereje, inertesh silici dhe/ose gëlqerorësh të përzgjedhur, shtuesish dhe pigmentesh specifike, që i atribuojnë produktit karakteristika avullimi, punueshmërie dhe pandryshueshmërie të lartë kromatike. Të rekomanduar sidomos si sheshues rregullues dhe uniformues mbi suva pa lagështirë dhe përthithëse me bazë gëlqereje ose gëlqere-çimento.

Fusha e përdorimit

Sheshim rregullues e zbukurues mbi sipërfaqe të brendshme e të jashtme, të reja e të staxhionuara, aty ku nevojitet një finiturë me karakteristika të larta avullueshmërie të linjës Macrosan; e përshtatshme edhe për mbajtëse të çimentuara ose gëlqere-çimento.

Avantazhet

- Përthithje e lartë
- Ngjeshje optimale mbi suva të vjetra e të reja
- Larmi e madhe dekorimesh dhe ngyrimesh
- Mundësi efektshëm kromatike tipike të veshjeve të vjetra me gëlqere
- Qëndrueshmëri ndaj agjentëve atmosferikë

Materialet e duhura

- Suva reduktuese e lagështirës ose transpiruese
- Suva të vjetra, edhe të plasaritura, por të patrajtuara me stoli akrilike
- Suva të parapërziera, tradicionale ose solucione të kryqëzuara
- Mbajtëse çimentoje ose me bazë gëlqereje

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet e reja duhen staxhionuar e duhet të jenë të rregullta; muraturat e vjetra duhen mënjanuar më parë nga lyerjet e mëparshme, larë e ndrequr aty ku janë krijuar zgavra të dukshme.

Sidoqoftë hiq çdo pjesë të pakapur mirë apo që duket se po shqitet. Apliko mbushësin e përgatitjes së sfondit EKOFOND B400 (shih skedën teknike).

Mënyra përdorimi

MACROSAN FINITURA L10, F60, M120 janë produkte paste të gatshme për përdorim, por është e nevojshme të ripërzihen për rreth 3 minuta për të arritur tek një produkt i butë, homogjen e i kollajtë për përdorim. Lihet të pushojë për 5 minuta, ripërzihet shkurt dhe, me spatul në çelik inoks, hapet produkti në dy kalime, me një interval prej 8-12 orë nga njëri-tjetri (në lidhje me temperaturën e lartë dhe me kushtet e mjedisit), duke realizuar një trashësi përfundimtare jo më të madhe sesa ajo që tregohet në të dhënat teknike; pastaj lustrim me perdash sfungjeri ose nivelues plastik për të arritur efektin e dëshiruar.

Të dhëna teknike* dhe aplikuese**

	L10 (e butë)	F60 (e hollë)	M120 (e mesme)
* Pamja	Pastë	Pastë	Pastë
* Paketim	kovë 20kg	kovë 20kg	kovë 20kg
* Ngjyra	Kartelë ngjyrash	K. ngjyrash	K. ngjyrash
* Pesha specifike	1,5kg/l	1,7 kg/l	1,75 kg/l
* Konsum i mesëm për 2 kalime	1kg/m ²	2,5 kg/m ²	3,5 kg/m ²
* Koeficienti i qëndrueshmërisë në avull	μ > 12	μ > 12	μ > 12
* Ujë përzierjeje për ambalazh	gati	gati	gati
* Trashësia maks përfundimtare e arritur	1 mm	2-3 mm	3-4 mm
* Thërrmim maksimal	0,0 mm	0,6 mm	1,2 mm
* Kohë pritjeje mes dy kalimeve	8-12 orë	8-12 orë	8-12 orë
* pH	13	13	13
* Temperaturë përdorimi	+8°C / +25°C	+8°C / +25°C	+8°C / +25°C
* Kohë ruajtjeje	12 muaj (në ambalazhim të plotë, mbajtur fresk, mbrojtur nga ngrirja		
* Vegla	Trapon përzierës, spatul inoks, perdah		

Paralajmërimë

- ** Apliko kapsollën EKOFOND B400
- ** Mos e përdor mbi mbajtëse tepër të nxehta, ku ka erë shumë apo në pishë të diellit
- ** Mbroje materialin e përdorur nga shiu intensiv 24 orët e para
- ** Mos e përdor mbi mbajtëse të paqëndrueshme, të thërrmueshme e të pluhurta, nëse nuk janë përforcuar më parë
- ** Mos e përdor mbi mbajtëse të ngrira apo që mund të ngrihen 24 orët e ardhshme pas shtrirjes
- ** Parashiko linjat e ndërprerjes në përputhje me lidhjet, shiun apo këndet

Vërejt! Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në punë.